

dialogu qeveridonorë

Buletin Informativ – Qershor 2011, Botimi nr. 51

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al

Marrëveshja e Huasë për Reforma në Politikat e Zhvillimit në Sektorin Social

Më 20 Qershor 2011, qeveria shqiptare dhe Banka Botërore (BB) nënshkruan një marrëveshje për Huanë për Reforma në Politikat e Zhvillimit në Sektorin Social, në një shumë prej 25 milion dollarësh amerikanë. Marrëveshja u nënshkrua nga Ministri i Financave, Ridvan Bode dhe Drejtuesja Rajonale e Bankës Botërore, Kseniya Lvovsky. Ceremonia u mbajt në Ministrinë e Financave në prani të zyrtarëve të lartë të qeverisë, si dhe anëtarëve të grupit që organizoi projektin, i cili u miratua më 28 Prill 2011 nga Bordi i Drejtuesve Ekzekutivë të Bankës Botërore.

Kjo hua mbështet reformat e Shqipërisë që kanë si qëllim përmirësimin e efikasitetit të rrjeteve shoqërore të sigurisë dhe rritjen e efektshmërisë dhe barazisë së financimit shëndetësor. Këto reforma, për Ndhmën Ekonomike dhe sigurimin shëndetësor, të miratuara nga Parlamenti në fillim të këtij viti, mbështesin politika që forcojnë mekanizmat për dhënien e fondëve dhe përzgjedhjen e përfitimeve në programin kryesor të ndihmës sociale. Reformat nxisin investimet në vetë popullatën, duke dhënë përfitime shtesë për regjistrimet në shkollë dhe ndihmë për familjet me fëmijë në moshë për shkollë; shënojnë fillimin e procesit të krijimit të një regjistri të unifikuar të përfitimeve dhe ndihmave sociale dhe ndryshimin e formulave të indeksimit të paaftësive të programeve të përfitimit. Kjo veprimtari mbështet gjithashtu masat për nxitjen e efikasitetit dhe barazinë e shpenzimeve për shëndetin duke prezantuar rregulla më të parashikueshme fiskale për financimin shëndetësor; përmirësimin e metodave të kontraktimit të ofruesve dhe mundësinë e monitorimit të punës së tyre dhe garantimin e mbulimit të sigurimit shëndetësor për përfitime dhe ndihmë sociale.

“Në të dy këto sektorë ka patur zhvillime në ndihmë të të varfërve, por nevojiten ndryshime të mëtejshme për të mbështe-



Foto: Ministri i Financave, Ridvan Bode dhe Drejtuesja Rajonale e Bankës Botërore, Kseniya Lvovsky, duke nënshkruar marrëveshjen e Huasë për Reforma në Politikat e Zhvillimit të Sektorit Social (DPL), që kap shumën prej 25 milion dollarësh amerikanë

Banka Botërore Mbështet Shqipërinë në Mbrojtjen e Grupeve në Rrezik dhe Financimeve Shëndetësore

tur këtë veprimtari”, tha Daniel Dulitzky, menaxher sektori dhe drejtues i projektit. “Në rrjetet e sigurisë sociale, qëllimi është të përmirësohet barazia, efikasiteti dhe transparenca në përdorimin e burimeve për uljen e varfërisë, ndërsa në sektorin e financimit shëndetësor, objektivi kryesor është rritja e aksesit për grupet në nevojë, përmirësimi i efikasitetit në ofrimin e shërbimit dhe rritjen e transparencës në sektorin e financimit shëndetësor”. “Do të doja të falënderoja Bankën Botërore për angazhimin ndaj Shqipërisë dhe mbështetjen ndaj reformave të qeverisë në sektorin social dhe zonat, në të cilat ekspertiza e kësaj banke është e domosdoshme”, tha Ministri i Financave, Ridvan Bode, gjatë cer-

emonisë së nënshkrimit. “Për më tepër, do të doja të siguroja Bankën Botërore se ne do t’i vazhdojmë këto reforma, sepse qeveria është e vendosur për implementimin sa më shpejt të tyre.” Drejtuesja rajonale e Bankës Botërore në Shqipëri, Kseniya Lvovsky, duke iu referuar vizitës së saj të fundit në komunën e Bërzhitës, shtoi: “Pata mundësinë të njihja disa nga përfituesit e Ndhmës Ekonomike dhe kjo përvojë më rikonfirmoi rëndësinë e reformave në sektorin social. Për shembull, Ndhma Ekonomike i mundësoi një familjeje të varfër me gjashtë fëmijë të vazhdojë të çojë fëmijët e saj në shkollë dhe u dha atyre mundësinë të bëhen anëtarë më të integruar në shoqëri.”

Në këtë numër

- Banka Botërore mbështet Shqipërinë në Mbrojtjen e Shtresave në Nevojë dhe Përmirësimin e Financimeve Shëndetësore
- Intervistë me Përfaqësuesen e Përhershme të Bankës Botërore, Kseniya Lvovsky
- Takimet Vjetore të Fondit Evropian për Evropën Juglindore, Bankës për Tregti dhe Zhvillim të Detit të Zi dhe Bankës Evropiane për Zhvillim
- Donatorët japin fonde për zbatimin e projektit të rrugës Tiranë – Elbasan
- Shqipëri-Kinë, nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje – synon arritjen e barazisë gjinore në shoqëri
- Zyra e Bashkëpunimit Zviceran feston përvjetorin e pesëmbëdhjetë të Punës për Zhvillim në Shqipëri
- Konferenca mbi Bujqësinë Organike promovon Potencialin dhe Mundësitë e Shqipërisë në Prodhimin dhe Tregtimin e Produkteve Organike
- USAID-i prezanton programin Shqiptar për Sigurinë Kibernetike
- Forumi i Donatorëve të NVM-ve
- Kombet e Bashkuara në Shqipëri prezantojnë Raportin Vjetor për vitin 2010
- Plani Operativ për Strategjitë Mjedisore në Vend
- OKB për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) krijon mundësi për zyrtarët qeveritarë dhe OJQ-të lokale për “Buxhetimin përgjegjës gjinor”
- Rrjeti i Grave Sipërmarrëse në qarkun e Korçës
- Trajnimi i PAMECA III IBM për procedurat e Vlerësimit të Schengen-it
- Policia e Shtetit, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri dhe UNICEF mbështesin “fëmijët e humbur” në Shqipëri
- Seminar i Programit për Zhvillim Rajonal të Shqipërisë Veriore
- Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjerman shpall fituesit e “Programit për Rrjetin e Biznesit Krijues”
- Konferenca mbi Projektin e Reformave për Forcimin e Lidhjeve në Ballkan
- Bashkimi Evropian mbështet luftën kundër pastrimit të parave në Shqipëri



Intervistë me Përfaqësuesen e Përhershme të Bankës Botërore, Kseniya Lvovsky

Znj. Kseniya Lvovsky arriti në Shqipëri në Shtator të 2010 për të nisur detyrën e saj si Përfaqësuese e Përhershme e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri, pas një pune 17 vjeçare në Zyrat Qendrore të Bankës Botërore në Uashington, SHBA. Detyra e saj e mëparshme në Bankën Botërore ishte menaxhimi i ndryshimit të klimës, përgjegjëse për strategjinë e parë për zhvillim në ndryshimin e klimës. Ajo solli një përvojë zhvillimi të gjerë në Evropën Lindore, Azinë Qendrore, Azinë Jugore dhe Lindore dhe në menaxhimin e programeve globale. Zona të ekspertizës përfshinin politikën ekonomike, zhvillimin e infrastrukturës, furnizimin me ujë dhe higjienën publike, shëndetit mjedisor dhe ndryshimit të klimës. Kseniya është autore kryesore ose bashkëautore e disa raporteve dhe botimeve të tjera të Bankës Botërore.

Çfarë është përfshirë në Strategjinë e Partneritetit të Vendit 2011 – 2014? Cilët janë sektorët kryesorë që do të mbështeten nga Banka Botërore? Cila ka qenë dhe është përparësia e ndihmës së saj?

Strategjia e Partneritetit të Vendit të Bankës Botërore për 2011 – 2014, miratuar në Korrik 2010, u krijua duke u këshilluar me Qeverinë dhe një sërë grupesh interesi, duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Ajo mbështet Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim duke u fokusuar në tre objektiva strategjike:

- përsheptimi i kthimit të Shqipërisë

në përqindjet e larta në një Evropë të pas-krizës;

- zgjerimi dhe mbështetja e përfitimeve sociale në Shqipëri;
- menaxhimi i burimeve ujore, duke marrë parasysh nevojën për të ulur dëmtimet që çojnë në ndryshimet klimaterike.

Qëkurse Shqipëria është bërë anëtare e Bankës Botërore në 1992, Banka ka mbështetur një sërë sektorësh, duke përfshirë mbrojtjen sociale, kujdesin shëndetësor, arsimin, infrastrukturën, energjinë, bujqësinë, sektorin bankar, administratën publike, menaxhimin financiar, si dhe klimën e biznesit, kryesisht nëpërmjet financimeve koncesionare të ANZH-së. Pjesë të rëndësishme të Strategjisë së Partneritetit të Vendit (SPV) kanë në fokus të tyre financimet e BERZH-it (jo koncesionare) në zonat me ndikim të lartë; një përpjekje të përbashkët të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (KNF), degët e sektorit privat në Bankën Botërore; fuqizimin e bashkëpunimit me partnerë të tjerë për zhvillim dhe integrim; mbështetjen e vazhdueshme për përmirësimet në qeverisje. Zonat kyçe me prioritet për SPV-në janë qeverisja, konkurrenca, aftësitë, rrjetet e mbrojtjes sociale, menaxhimi i ujërave, ambientit dhe burimeve natyrore për të mbështetur rritjen ekonomike. Financimi kap shumën totale prej 300 milion dollarësh amerikanë nga Banka BERZH, që është më e lartë nga shuma e parashikuar prej 275 milion dollarësh amerikanë, në ndihmë të përblyerjeve në fund të vitit 2010; ndërsa financimet e KNF-së për sektorin privat pritet të rriten në 120 – 150 milion dollarë amerikanë.

Një vlerë e rëndësishme në ndihmën

tonë është kombinimi i financimit në kushte tërheqëse duke njohur zhvillimin global dhe lehtësitë në zbatim. Banka Botërore përdor përvojën dhe ekspertizën e saj unike me sfidat dhe rrethanat e shumta për të ndihmuar në fuqizimin e institucioneve. Ajo jep ndihmesën e saj në testimin e modeleve dhe zgjidhjeve të reja që këto institucione mund të ndër-marrin, për t'i mbështetur vetë më tej. Sot Shqipëria është një vend me të ardhura të mesme, e njohur nga ANZH dhe që mund të pranojë vetëm financimet e BER-ZH-it për investimet publike, çka e bën rolin tonë më të rëndësishëm.

Që kur keni ardhur në Shtator 2010, cilat janë sipas jush çështjet më kritike ose arritjet më të rëndësishme? Cilat janë prioritetet specifike të vendit dhe si do ta ndihmojë Banka Botërore për t'i arritur?

Edhe pse e fillova detyrën time gjatë krizës globale financiare, e cila ngadalësoi rritjen e dekadës së mëparshme, kam qenë me fat që kam qenë dëshmitare e disa arritjeve shumë të mëdha. Më e rëndësishmja, Shqipëria i është përmbajtur ndikimit të krizës globale në ekonominë e saj. Është një nga të paktat vende në Evropë që ka ruajtur një përqindje në rritje. Qeveria ka emetuar me sukses Eurobond-in në Tetor 2010, duke e përdorur për të paguar disa nga borxhet më të mëdha dhe ka arritur një ulje të rëndësishme të deficitit fiskal në 2010, krahasuar me 2009, duke mundur kështu rritje më të fortë. Performanca e sektorit bankar dhe menaxhimi i inflacionit kanë qenë të kënaqshme. Përgjigja ndaj përmbajtjeve të Nëntor-Dhjetorit 2010 ka qenë shembullore. I shtojmë kësaj liste edhe ndikimin në paqendrueshmërinë globale në çmimet e ushqimeve që kanë goditur ashpër disa nga vendet e tjera në zhvillim, por në Shqipëri kjo paqendrueshmëri ka qenë shumë pak e ndjeshme. Qeveria ka vazhduar të ketë prioritet të saj për mirësimin e jetesës për shtresat në nevojë, përfshirë rritjen e mundësisë së tyre për të ardhmen, duke miratuar dy ligje të rëndësishme për ndihmën sociale dhe siguri-min shëndetësor për të varfërit.

Një sfidë afat-mesme është të përmbushen reformat dhe të rritet prodhimtaria në disa sektorë kyç, ndërsa mbështetet hapja e vendeve të punës. Për të ruajtur rritjen ekonomike dhe përmbushjen e standardeve të BE-së, do të ishte e rëndësishme t'i kushtohej më shumë rëndësi menaxhimit të cilësisë

së tokës, ujit dhe mjedisit, fuqizimit të shtetit ligjor. Rregullat të bëhen më të qarta dhe të sigurohemi për zbatimin e tyre.

Banka Botërore po e ndihmon vendin me financime, ekspertizë dhe ndihmë teknike. Portofoli aktual konsiston në 11 projekte aktive me fokus qendror në energji, transport, sektorin social dhe mjedis. Në fillim të këtij viti, Banka miratoi Huanë e Politikave të Zhvillimit në një shumë prej 25 milion dollarësh amerikanë në mbështetje të reformave për mbrojtjen sociale dhe ndihmën financiare. Ajo do të ndiqet nga investimet për ndihmën sociale, që janë duke u përgatitur dhe do të mbështesin vënien në zbatim të këtyre reformave. Projekte të tjera që janë duke u përgatitur përfshijnë: Projektin e Investimit në Sektorin e Ujit, Projektin e Buri-



Banka Botërore po e ndihmon vendin me financime, ekspertizë dhe ndihmë teknike. Portofoli aktual konsiston në 11 projekte aktive me fokus qendror në energji, transport, sektorin social dhe mjedis

meve Ujore dhe të Vaditjes, si dhe Huaja e Politikave të Zhvillimit për qeverisjen dhe konkurrencën. Strategjia e Partneritetit të Vendit ka në plan projekte për menaxhimin mjedisor, arsimin e lartë dhe aftësimin.

Gjatë vitit që kaloi, Banka Botërore ka kryer analiza për të drejtën e pronës, drejtimet qeverisëse, ujin, arsimimin, mbrojtjen sociale, sektorin financiar dhe përshtatjen e ndryshimit klimaterik në energji dhe bujqësi. Një seminar një ditor për përmirësimin e qeverisjes në Shqipëri është programuar për në fillim të Shtatorit, për të ndarë rezultatet e shumë anali-

zave të Bankës Botërore dhe iniciativave të lidhura me promovimin e qeverisjes së mirë.

Banka Botërore ka negociuar dhe miratuar kohët e fundit një Hua të Politikave të Zhvillimit. Cilat janë politikat që do të mbështeten? Çfarë veprimesh të tjera të HPZH-së keni në plan?

Ky aksion i ri prej 25 milion dollarësh amerikanë, siç u përmend më lart - reforma në Sektorin Social të HPZH-së - mbështet objektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e programeve të ndihmës sociale, veçanërisht Programin e Ndihmës Ekonomike, për t'u shërbyer më mirë të varfërve, si dhe për të përmirësuar të drejtën e përfitimit të shërbimeve shëndetësore. Miratimi u parapri nga një numër aksionesh të ndërmarrja nga qeveria dhe të miratuara në Parlament në Shkurt dhe Mars të këtij viti. Shembujt e këtyre veprimeve janë: dhënia e një bonusi për mbështetjen e fëmijëve të familjeve në nevojë për të vazhduar arsimin e detyrueshëm, krijimi i një regjistri kombëtar për aplikantët dhe përfituesit, me një paketë të plotë përfitimesh; dhe fuqizimi i proceseve për financimin e spitaleve. Investimet në ndihmën sociale, të cilat po i përgatisim, mbështesin përmirësimin e administrimit të Ndihmës Ekonomike.

Ne jemi duke punuar gjithashtu me qeverinë në programimin e një sërë veprimesh të politikave për zhvillim, për të forcuar të drejtën e pronës, qeverisjen dhe rritjen e konkurrencës, në mënyrë që të lehtësojmë rritjen ekonomike dhe procesin e integritimit në BE. Nëse gjithçka shkon sipas planit, do të jepen tri hua, me nga 25 milion dollarë amerikanë secila, në 2012, 2013 dhe 2014.

Banka Botërore ka botuar në 2010 Memorandumin Ekonomik të Vendit – Agjenda e Re e Rritjes Ekonomike. Çfarë përfshin ajo?

Memorandumi Ekonomik i Vendit shqyrton performancën ekonomike të vendit, identifikon pengesat e rritjes ekonomike dhe ofron analiza për të ndihmuar në hartimin e politikave që do të kapërcenin këto pengesa. Ai fokusohet në sfidat e rritjes ekonomike me të cilat përballet Shqipëria, si një vend i sapoardhur në grupin e vendeve me të ardhura të mesme, në një mjedis të jashtëm të vështirë, pas krizës globale dhe me zhvendosje të mëdha në pushtetin global ekonomik. Raporti analizon dobësitë e

mundshme dhe propozon masa për ruajtjen e stabilitetit makro-financiar. Raporti vendos arsimin dhe aftësitë në qendër të agjendës së re për rritjen ekonomike. Raporti propozon gjithashtu masa të nevojshme për të përfunduar krijimin e një infrastrukture shtyllë, siç është energjia dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit dhe për të përmirësuar klimën e investimeve. Shumë rekomandime të raportit janë duke u pasqyruar në programin e lartpërmendur të HPZH-së për qeverisjen dhe konkurrencën që do të shtrihet në tre vitet në vijim.

Banka Botërore ka qenë kryesuese në Sekretariatit Teknik të Ndhmës së Huaj gjatë gjashtë muajve të fundit. Si ju duket bashkëpunimi i donatorëve në Shqipëri dhe cili është roli i Bankës Botërore?

Mekanizmi i koordinimit të ndihmave të huaja në Shqipëri është i mirë-themeluar dhe po arrin rezultate të larta. Shumë prej projekteve që financojmë – për shembull në transport, energji, arsim dhe mjedis – janë të bashkëfinancuara edhe nga banka të tjera ndërkombëtare dhe/ose donatorë bilateral. Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI), financiar nga fonde multi-donorësh është një tjetër shembull i bashkëpunimit të fortë mes tyre. Banka Botërore punon bashkë me agjencitë e OKB-së në shumë çështje, sidomos në ato të varfërisë dhe barazisë gjinore. Rëndësia që i jep qeveria koordinimit të ndihmës së huaj shihet në faktin se Shqipëria është një nga vendet pilot të “OKB e Shpërndarë si Një”. E ardhmja, sipas pikëpamjes time, do të mbështetet në ndihmën e donatorëve për të arritur prioritetet dhe për të plotësuar programet e qeverisë. Është një rol kyç i qeverive, jo donatorëve, të bashkëpunojnë dhe të arrijnë rezultatet më të larta nga burimet e donatorëve – teknike dhe financiare, ashtu siç e kërkon edhe deklarata e Parisit për efektivitetin e ndihmave. Më vjen mirë që në fund të rotacionit drejtues të Bankës Botërore të Sekretariatit Teknik të Donatorëve (STD), u mor vendimi se qeveria, përfaqësuar nga DEBASKON-i, do të bëhet një bashkë-kryetare e STD-së. Ne zotohemi të mbështesim DEBASKON-in në rolin e saj si anëtare e STD-së. Në të njëjtën mënyrë, ne në Bankën Botërore – si shumë partnerë të zhvillimit dhe integrim-it të Shqipërisë – do të donim të shihnim një drejtim dhe aktivizim më të fuqishëm të Grupeve Sektoriale të Punës nga linjat respektive të ministrive. Këta grupe pune duhet të mbështesin qëllimet dhe pro-

gramet e ministrive, jo prioritetet e donatorëve të ndihmave të huaja dhe do të ishte inkurajuese të shihnim që ky proces ka filluar. Më në fund, bota ka ndryshuar dhe ka shumë donatorë të rinj e të rëndësishëm në skenën globale, siç mund të përmendim Korenë e Jugut, Kinën, Brazilin, Rusinë. Për shembull, Koreja e Jugut ka zgjeruar mbështetjen e saj në trajnimin e qeverisjes elektronike në Shqipëri nëpërmjet Bankës Botërore. Për të ecur përpara, do të ishte me vlerë që të bashkërendohen lojtarë të rinj në strukturën e koordinimit të ndihmës së huaj në Shqipëri.

Duke qenë vetë një grua, si ju duket çështja e barazisë gjinore në Shqipëri?

Unë shoh se në Shqipëri ka një numër të madh grash të talentuara – në Qeveri, parlament, shoqërinë civile dhe sektorin privat. Shumë prej tyre njihen, meqë mbajnë poste të larta dhe prestigjioze, ndërsa të tjera qëndrojnë në hije. Janë ndërmarë hapa të rëndësishëm që gratë e brezit të ardhshëm të kenë mundësi më të mëdha, duke qenë se vajzat dalin më mirë se djemtë në provimet në shkollë. Në të njëjtën kohë, në disa pjesë të vendit dhe në disa segmente të shoqërisë, s’mund të anashkalohet ndjesia se duhet bërë më shumë. Ne kemi intervistuar së fundmi një grua që përfitonte Ndhimë Ekonomike, e cila ishte braktisur nga i shoqi, çka kishte qenë një goditje e rëndë për të dhe dy vajzat e saj. Ndërsa vizitonim disa zona rurale, kisha vështirësi për të takuar dhe për të folur me femra në fshatra. Mund të them se është kontrast i fortë me Indinë që është një vend më i varfër, ku gratë në zona rurale janë organizuar, nën mbështetjen e qeverisë, në grupe vet-ndihmuese dhe mezi presin të flasin për projektet e tyre,

arritjet dhe planet e së ardhmes.

Është gjë e mirë që në nivelin më të lartë të qeverisë ndodhet një grua, por edhe një mundësi për të bërë më shumë. Po tregohem më e qartë: Shqipëria po ecën në drejtimin e duhur duke miratuar ligje të barazisë gjinore dhe duke hapur më shumë mundësi për brezat e ardhshëm. Duhet gjithmonë kohë për ndryshimin e normave shoqërore. Meqë ra fjala, tema e këtij viti në Raportin Botëror Për Zhvillim është Gjinia dhe Zhvillimi, një botim vjetor i Bankës Botërore dhe unë mezi pres që ta diskutojmë atë me publikun shqiptar.

Faleminderit për mundësinë që më dhatë të ndanim informacione për Bankën Botërore dhe disa nga pikëpamjet e mia. Mezi presim të vazhdojmë bashkëpunimin tonë me të gjithë ju.

Faleminderit znj. Lvovsky. Ju urojmë fat dhe suksese në misionin tuaj.

Takimi Vjetor i Fondit Evropian për Evropën Juglindore

Më 6 deri 8 Qershor 2011, më shumë se 300 pjesëmarrës nga rreth 30 vende morën pjesë në Takimin Vjetor të Fondit Evropian për Evropën Juglindore. Banka e Shqipërisë ishte bashkëorganizatore e këtij takimi dhe dha mbështetjen e saj thelbësore nën drejtimin e Guvernatorit të saj, Ardian Fullani. Takimi u hap nga kryeministri, Sali Berisha dhe Guvernatori Fullani, si dhe përfaqësues nga Komisioni Evropian (KE), Qeveria Gjermane dhe KfW. Aspekte dhe mundësi të reja për zhvillimin financiar në Evropën Juglindore dhe Kaukaz pas krizës, me fokus



Foto: Takimi Vjetor i Fondit Evropian për Evropën Juglindore (FEEJ) i mbajtur më 6 deri 8 Qershor 2011

mikro-ekonominë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ishin temat që u diskutuan, ku titulli kryesor ishte: “Formësimi dhe Shfrytëzimi i Realitetit të Ri”. Diskutimet interaktive të panelit dhe seminarët mundësuan një platformë unike për shkëmbimin e informacionit mes përfaqësuesve të institucioneve financiare partnere, akademikëve, qeveritarëve, si dhe donatorëve dhe investitorëve privatë. Komiteti Evropian, i përfaqësuar nga Gerhard Schumann-Hitzler, konfirmoi mbështetjen e tij të vazhdueshme për misionin e Fondit Evropian të Evropës Juglindore, gjithashtu edhe për vendet e reja partnere, duke përfshirë Kroacinë dhe Turqinë. Ambasadorja gjermane në Shqipëri, Carola Muller-Holtkemper, nënvizoi gjatë fjalimit të saj avantazhet e zbatimit të reformave ligjore. Mbledhjet vjetore mbahen çdo vit në vende të ndryshme të rajonit që përfshin Fondi Evropian i Evropës Juglindore, në mënyrë që të nxitet debati për tema jetike në zhvillimin financiar mes palëve të interesuara publike dhe private të Fondit.



Foto: Kryeministri Berisha duke takuar Kryetarin e Bordit të Guvernorëve të BEZH-it, Raphael Alomar

Banka për Tregti dhe Zhvillim e Detit të Zi mban Takimin Vjetor në Tiranë

Më 19 Qershor, Bordi i Guvernorëve të Bankës për Tregti dhe Zhvillim të Detit të Zi (BTZHDZ) mbajti Takimin e saj të Tretë në Tiranë nën drejtimin e z. Nezir Haldeda, Guvernor i BTZHDZ për Shqipërinë dhe Zëvendës Ministrit të Financave. Bordi miratoi deklaratat financiare të Bankës për vitin 2010. Banka shpërndau një përfitim prej 10.7 milion eurosh për gjashtë vitet e ardhshme, pavarësisht efekteve negative të krizës financiare botërore. Aktiviteti operativ i Bankës u mëkëmb në 2010, pas politikave të vështira por të nevojshme për maturi dhe shkrirje, të ndjekura në 2008 – 2009. Miratimet e reja operative arritën deri në 215 milion euro në 2010, një rritje prej 36 % në krahasim me vitin 2009; ndërsa nënshkrimet e projekteve të reja u rritën me 90 % nga viti në vit, deri në 199 milion euro. Gjatë vitit 2010, BTZHDZ ia doli të mbante një cilësi të lartë të kredisë në huatë e saj. Efektiviteti operativ dhe mbështetja e fortë e aksioneve bënë që të rritej shkalla e vlerësimit në A/A1 nga Standard & Poor’s, më 16 Qershor 2011. Kjo u ndoq nga një rritje afatgjatë në shkallën A3 nga Moody’s Investor Service më 30 Shtator 2010.

Këto vlerësime do t’i mundësojnë

Bankës më shumë fonde dhe kësiaj ajo do t’u mundësojë klientëve të saj kushte më të mira financimi në rajon. Bordi i Guvernorëve vendosi t’i japë Statusin Vëzhgues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila e çoi numrin e institucioneve Vëzhguese të BTZHDZ në nëntë njësi. Bordi zgjodhi z. Arthur Javadyan, Guvernor i Armenisë, kryetarin e Bordit të Guvernorëve dhe Guvernorët e Azerbajxhanit dhe Bullgarisë si zëvendëskryetarë për një periudhë një vjeçare. Takimi vjetor i radhës i Bordit të Guvernorëve të BTZHDZ-së do të mbahet në Yerevan, në Armeni, në Qershor 2012.

BTZHDZ është një institucion financiar ndërkombëtar i themeluar nga Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia, Moldavia, Rumania, Rusia, Turqia dhe Ukraina. Zyrat qendrore të BTZHDZ-së janë në Selanik, në Greqi. BTZHDZ mbështet zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin rajonal duke mundësuar huadhënien, linjat e kredisë, barazinë dhe garancitë për projektet dhe financimin e sektorëve privatë dhe publikë në vendet anëtare. Kapitali i Bankës shkon në 3.3 miliard euro.

Takim i përbashkët i Bankës Evropiane për Zhvillim i mbajtur në Tiranë, më 10 dhe 11 Qershor

Takimi i përbashkët i 46-të i Bankës Ev-

ropiane për Zhvillim, që mbledhi bashkë Bordin Drejtues të Institucionit, Këshillin Administrativ dhe Drejtuesit, u mbajt këtë vit në Tiranë, më 10 dhe 11 Qershor.

Gjatë këtij takimi, Bordi Drejtues zgjodhi z. Raphael Alomar si kryetar të Bordit; z. Joseph Licari si kryetar të Këshillit Administrativ dhe z. Apolonio Ruiz-Ligero në postin e zëvendës Guvernorit për Strategjitë e Zhvillimit Social.

Më tej, gjatë mbledhjes së Këshillit Administrativ u miratuan tetë projekte të reja, me një shumë prej 509 milion eurosh. Takimi i Përbashkët i BEZH-it u parapri nga një seri takimesh zyrtare mes Guvernorit Alomar dhe autoriteteve të larta të vendit: Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Financave, i cili mbajti një fjalim në seancën e përbashkët të Bordit Drejtues të Bankës dhe Këshillit Administrativ. BEZH-i është institucioni më i vjetër financiar në Evropë, i themeluar nga tetë shtete anëtare, me një kapital prej 5.7 milion eurosh.

Miratohet kredia e Fondit Saudit prej 25 milionë dollarë për zbatimin e projektit të rrugës Tiranë – Elbasan

Fondi Saudit për Zhvillim miratoi një kredi prej rreth 25 milionë USD për projektin e rrugës Tiranë - Elbasan. Miratimi zyrtar i kredisë nga Fondi Saudit për Zhvillim është konfirmuar nga Ambasa-

dori i Arabisë Saudite në Tiranë z. Abdulah Abdulaziz AL-ABDULKARIM, gjatë një takimi që pati me Ministrin e Financave z. Ridvan Bode, më 24 qershor 2011. Ministri falënderoi Ambasadorin për miratimin e kredisë, e cila është me terma financiare shumë të favorshme sidomos kur flitet për projekte infrastrukture, çka dëshmon vlerësimin e lartë të Fondit Saudit për avantazhet teknike dhe financiare të këtij projekti. Kredia ka një normë interesi 2% dhe afat maturimi 25 vjet, nga të cilat 5 vitet e para janë pa pagesë.

Marrëveshja e kredisë prej 222.7 milionë dollarë me Bankën Islamike për Zhvillim (IDB) për financimin e rrugës Tiranë – Elbasan është nënshkruar më 7 prill 2011. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Ministri i Financave z. Ridvan Bode dhe presidenti i Bankës z. Ahmed Mohamed Ali. Kredia prej 222.7 milionë dollarë ofrohet nga IDB me një maturim 17 vjeçar plus tre vjet pa pagesë me interesa. Norma e interesit bazohet në indeksin (SWAP Rape) 17 vjeçar të dollarit amerikan plus 1.2 % interes (rreth 5 % në total). Ministri i Financave, z. Bode e ka vlerësuar këtë marrëveshje kredie si “një nga marrëveshjet me shumën më të madhe në një transh të vetëm të nënshkruar me një bankë të vetme siç është IDB. Ky financim përbën mbulimin me fonde të njëtrës prej veprave më të rëndësishme të mandatit të dytë të qeverisjes, segmentin Tiranë - Elbasan pjesa kryesore e aksit kombëtar të jugut”.

Vlera totale e investimit të segmentit prej 400 milionë dollarësh do të vijojë të ndërmjetësohet përmes IDB-së duke kontraktuar dhe donatorë të tjerë si: Fondi i Abu Dhabi-t - i është kërkuar të financojë në shumën 100 milionë USD; si dhe kontributi i Qeverisë Shqiptare i cili do të mbulojë pjesën tjetër të kostonë së projektit.

Bordi Drejtues OFID miraton huatë dhe grantet e reja

Më 17 Qershor 2011, Bordi Drejtues i Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar mbajti seancën e tij të 135-të, si dhe miratoi mbi 116 milion dollarë amerikanë për financime të reja. Fondet do të mbështesin nëntë projekte në vende të ndryshme në Azi, Afrikë, Amerikën Latine, Karaibe dhe Evropë. Baza e kësaj huaje mbështet energjinë dhe sektorin e transportit, ndërsa pjesa që mbetet do t'u

vijë në ndihmë projekteve në sektorin e bujqësisë.

Nëntë huatë në sektorin publik përfshijnë huanë që do t'i jepet Shqipërisë për rrugën Tiranë-Elbasan, në një shumë prej 20.40 milion dollarësh amerikanë. Rruga e gjatë 27 km Tiranë-Elbasan do të rrisë aksesin për shërbime sociale dhe tregti dhe do të ndihmojë promovimin e mundësive të tregtisë në vend. Rreth 750,000 njerëz jetojnë në kryeqytetin e Tiranës dhe qyteti i Elbasanit do të përfitojë rrugë më të sigurta udhëtimi.

Shqipëri-Kinë, nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar

Më 28 qershor 2011, Zëvendës Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Eno Bozdo dhe Zëvendës Ministri i Tregtisë së Republikës Popullore të Kinës, Zhong Shan nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi ekonomik, e cila konsiston në dhënie të një shumë prej 10 milion juanë kinezë për qeverinë shqiptare nga ana e qeverisë së Kinës, në formë granti. Marrëveshja u nënshkrua në praninë e përfaqësuesve të dy delegacioneve, si dhe të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, z. Nasip Naço. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, Zv.Ministri i METE z. Bozdo, u shpreh se kjo marrëveshje është e rëndësishme dhe tregon nivelin e marrëdhënieve shumë të mira ekonomike dhe politike mes Shqipërisë dhe Kinës. Ai theksoi faktin që kompanitë kineze kanë investuar suk-

sesshëm në fushën e industrisë minerare, në telekomunikacion, por qeveria jonë është shumë e interesuar për të tërhequr edhe investime në fushën e energjisë, veçanërisht në fushën e energjive të rinovueshme, në fushën e industrisë së lehtë dhe në të gjitha sektorët e tjerë të ekonomisë së vendit. Zv.Ministri i Tregtisë së Kinës, z. Zhong Shan, u shpreh se qëllimi i vizitës në Shqipëri është nxitja e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare mes dy vendeve. “Ne kemi biseduar me Ministrin dhe me Zv.Ministrin për fondet ekonomike-tregtare midis dy vendeve tona dhe kemi rënë në konsensus që qeveria kineze të inkurajojë ndërmarrjet kineze që të vijnë në Shqipëri për të investuar, si dhe për të bashkëpunuar në fusha të ndryshme, veçanërisht në infrastrukturë, në telekomunikacion, etj.”, u shpreh z. Shan.

Komiteti Ndërmintor i Integritetit diskuton mbi Raportin e Këshillit të Evropës për çeshtje të liberalizimit të vizave dhe Planit të Veprimit për 12 Pikat e Bashkimit Evropian

Më 10 Qershor 2011, Komiteti Ndërmintor i Integritetit diskutoi dy tema të rëndësishme: Raportin e Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Planin e Veprimit për zbatimin e 12 Pikave të Bashkimit Evropian. Për sa i përket temës së parë të takimit, u theksua se Raporti i



Foto: Zëvendës Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Eno Bozdo dhe Zëvendës Ministri i Tregtisë së Republikës Popullore të Kinës, Zhong Shan gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimi ekonomik,

Komiteti Evropian nuk ka hasur asnjë rritje në numrin e azil-kërkuesve nga Republika e Shqipërisë pas liberalizimit të vizave. Kjo u konsiderua si një arritje pozitive e cila konfirmon se qytetarët shqiptarë kanë adoptuar një sjellje të përgjegjshme ndaj vendimeve të qeverive të vendeve të Schengen-it. Tema e dytë ku u ndal Komiteti Ndërmintor i Integritimit ishte përmbushja e 12 rekomandimeve të Bashkimit Evropian për aplikimin për anëtarësimin në BE. Që më 31 Janar 2011, qeveria ka hartuar një Plan veprimi dhe këshillimi me KE-në, grupet e interesit, agjencitë në fjalë dhe shoqëri në civile.



PFoto: Takimi i Komitetit Ndërmintor i Integritimit, i mbajtur më 10 Qershor 2011

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunën në Familje synon arritjen e barazisë gjinore në shoqëri



Foto: Drejtorja e Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes në Ministrinë e Punës, Alma Marku

Gratë biznesmene në fshat dhe qytet do të favorizohen me grante dhe kredi. Qeveria shqiptare parashikon që brenda katër viteve të rrisë me 30% pjesëmarrjen e grave në sektorin privat dhe të zvogëlojë me 10% nivelin e papunësisë. Këto objektiva përcaktohen në “Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunën në Familje”, e shoqëruar me Planin e Veprimit 2011- 2015, miratuar nga Këshilli i Ministrave më 16 qershor 2011. Drejtorja e Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes në Ministrinë e Punës, Alma Marku, u shpreh për mediat se “strategjia e re fokusohet më shumë në përpjekjet drejt arritjes së

barazisë gjinore në Shqipëri, nëpërmjet integritimit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave”. Sipas Markut, në fund të 2015 arritja e objektivave të Strategjisë do të sjellë uljen e papunësisë në 10%. Për gratë nga 16% në 10% dhe për burrat nga 12% në 10%. “Janë përcaktuar aktorët dhe mekanizmat që do të bëjnë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së femrave në forcat prodhuese të punës me 21% (nga 44% në 65%)”, tha Marku, duke theksuar se qëllimi kryesor është rritja e pjesëmarrjes së grave në sektorin privat me 30%.

Strategjia e re ka në fokus zbatimin e kuotës prej 30% të grave në të gjitha nivelet e larta të vendimmarrjes politike dhe proceseve zgjedhore, uljen e varfërisë në zonat rurale me 10% dhe përafrimi i niveleve të varfërisë me ato të qytetit; kuadër ligjor të ashpër për tolerancë zero ndaj dhunës, etj.

Bashkëpunimi Zviceran feston 15 vjetorin e Punës për Zhvillim në Shqipëri

Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri (ZBZ-A) festoi 15 vjetorin e punës në vend. Në praninë e zyrtarëve qeveritarë, përfaqësuesve diplomatikë dhe partnerëve të shoqërisë civile, prania zvicerane në vend ka dërguar një mesazh të qartë: Ndhima për Zhvillim e Zvicrës do të vazhdojë përsëri në Shqipëri.

Më 30 Qershor 2011, Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri festoi përvjetorin e 15 në Shqipëri. Nën moton “Festimi i 15 Viteve Partneriteti të Frytshëm me Shqipërinë”, festimet kaluan nën një atmosferë të qetë me fjalime të shkurtra, biseda dhe muzikë.

“Prania jonë këtu erdhi në një kohë të vështirë për Shqipërinë”, tha Drejtori



Foto: Drejtori Rajonal i Bashkëpunimit Zviceran, Daniel Zuest, bashkë me stafin gjatë festimeve më 30 Qershor. Z. Zuest do të largohet pas pak kohësh nga Shqipëria për një detyrë të re, atë të Kryetarit të Zyrës së Bashkëpunimit në Ambasadën Zvicerane në Mozambik.

Rajonal i ZBZ-A, Daniel Zust, duke iu referuar vitit 1997, kur u hap për herë të parë zyra e përhershme në Shqipëri. “Kur shumë organizata ndërkombëtare i mbyllnin zyrat e tyre, evakuonin stafet dhe largoheshin nga vendi, ne erdhëm dhe filluam të jepnim kontributin tonë për të mbështetur një vend të shkatërruar nga trazirat politike dhe shoqërore”, vazhdoi më tej z. Zust. Ai gjithashtu deklaroi se organet Zvicerane për Zhvillim SDS dhe SECO kanë vendosur të vazhdojnë mbështetjen e tyre për Shqipërinë edhe pas vitit 2013.

Duke folur në emër të qeverisë zvicerane, Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler deklaroi se pavarësisht se është shumë e kujdesshme kur flitet për rezultatet e punës në vendet në zhvillim, ajo ka parë shumë arritje në punën e bërë nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri.

“S’ka gjë më të keqe se të kënaqesh me veten”, tha Ambasadorja Enzler, “por për sa i përket punës së Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri, jam krenare për rezultatet e arritura.”

Zyra e Bashkëpunimit Zviceran është themeluar në Shqipëri në Maj të vitit 1997. Shumë projekte të saja synojnë fuqizimin e qeverisjes lokale dhe qendrore, mbështetjen sociale, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujit dhe asaj energjetike.

Konferenca e Parë e Bujqësisë Organike promovon Potencialin dhe Mundësitë e Shqipërisë për të Prodhuar dhe Tregtuar Produkte Organike

Me mbështetjen e Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri, Konferenca e Parë Kombëtare për Bujqësinë organike u organizua nga Instituti i Kërkimeve për Bujqësinë Organike (IKBO). Kjo ngjarje mbledhi bashkë ministra, shërbime në mbështetje të biznesit, donatorë ndërkombëtarë dhe agrobiznese lokale të Shqipërisë, në mënyrë që të flitej për temën e rëndësishme të promovimit të bujqësisë organike.

Konferenca u mbajt më 30 Qershor 2011 dhe aty morën pjesë ministri i Bujqësisë, Genc Ruli, Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler dhe drejtori rajonal i Bashkëpunimit Zviceran, Daniel Zust. Tema të ndryshme lidhur me prodhimin dhe tregtimin e produkteve organike në Shqipëri u prezantuan nga grupe të ndry-



Foto: Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, z. Genc Ruli duke folur në Konferencën Kombëtare Organike në Tirana International Hotel.

shme interesi, si: përfaqësues të qeverisë, donatorë projektesh, ekspertë bujqësorë, njerëz të biznesit dhe të tjerë të interesuar në bujqësinë organike.

“Bujqësia organike është e lidhur me ushqimin”, deklaroi ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler. “Është e kujdesshme për shëndetin dhe ambientin ku ne jetojmë, punojmë dhe kalojmë kohën e lirë”. Ajo shtoi se “puna e disa pionierëve organikë në Shqipëri ka qenë e suksesshme dhe ne presim që edhe të tjerë të kenë rezultate të mira, çka do të sillte më shumë eksporte, më shumë të ardhura, më shumë punësim dhe më shumë begati për vendin”.

Një folës tjetër i rëndësishëm në konferencë ishte edhe Prof. Dr. Urs Niggli, Drejtor i IKBO-së, i cili tha se produktet organike do të bëhen një kategori e rëndësishme në supermarkete. “Ndërsa shtohet shqetësimi i konsumatorëve

në mbarë botën për problemet e shëndetit, produktet organike dhe mundësitë për t’i prodhuar do të shtohen më shpejt sesa e mendojmë ne”, tha Prof. Dr. Niggli. Përveç diskutimeve dhe kumtesave, në konferencë u organizua edhe një panair me produkte organike të prodhuara në Shqipëri, duke përfshirë furnizimet dhe shërbimet e biznesit dhe tregtarët. Konferenca shënon një hap të rëndësishëm në ndërgjegjësimin për mundësitë që ka Shqipëria për prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore organike.

USAID-i prezanton programin për Sigurinë Kibernetike në Shqipëri:

Më 13 Qershor 2011, USAID-i prezantoi Programin për Sigurinë Kibernetike në Shqipëri, një iniciativë një vjeçare që



Foto: Drejtori i Misionit Shqiptar të USAID-it, z. Joseph C. Williams, dhe ministri i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, z. Genc Pollo, mbajtën fjalën e hapjes gjatë ceremonisë së prezantimit të Programit për Sigurinë Kibernetike në Shqipëri.

do të rrisë mundësinë e qeverisë shqiptare për të ndalur dhe për t'iu përgjigjur incidenteve të sigurisë kibernetike. Drejtori i USAID-it në Shqipëri, z. Joseph C. Williams dhe Ministri i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, z. Genc Pollo mbajtën fjalën e hapjes në ceremoni. Më pas ekspertë të Institutit të Inxhinierisë Programuese (IIP) në Universitetin Carnegie Mellon drejtuan një seminar njëjavor për të ndihmuar institucionet kyçe të qeverisë shqiptare, si dhe ato joqeveritare, të kuptojnë modellet e sigurisë kibernetike, të kenë aftësi për t'u rezistuar kërcënimeve dhe të zhvillojnë proceset për menaxhimin e incidenteve në sigurinë kibernetike. Pjesëmarrës në seminar ishin Agjencia Kombëtare e Informacionit dhe specialistë të teknologjisë së informacionit nga institucione të ndryshme të qeverisë shqiptare, duke përfshirë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Policinë e Shtetit, Komisionin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Nga Shtatori 2011 deri në Mars 2012, IIP do të organizojë seminare të tjera që do t'i mundësojnë qeverisë shqiptare metodat dhe njohuritë e nevojshme për të ndërtuar sistemin e vet të sigurisë kibernetike, që do të mbrojnë Shqipërinë nga kërcënimet kibernetike, që mund të çonin më tej në sulme të rënda kibernetike.

Forumi i Donatorëve të NVM-ve

Më 6 Qershor 2011, 35 përfaqësues nga organizata të ndryshme morën pjesë në Forumin e Donatorëve të NVM-ve, ku përfshiheshin Institucionet shqiptare, përfaqësues të donatorëve, zbatues projektesh dhe palë të tjera të interesuara në zhvillimin e sektorit privat, në veçanti të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM). Kjo tryezë e rrumbullakët u organizua nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) në bashkëpunim me Kooperacionin Italian për Zhvillim. Konferenca u hap nga zëvendës ministri i METE-s, Eno Bozdo dhe nga drejtori i Kooperacionit Italian për Zhvillim, Aldo Sicignano. Takimi kishte si qëllim që të shfaqte rezultatet e para të zbatimit të Procesit të Bashkëpunimit të Donatorëve në këtë sektor. Në një linjë me parimet e Deklaratës së Parisit, Agjendës së Akrës



Foto: Zëvendës Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Eno Bozdo, me drejtorin e Kooperacionit Italian, Aldo Sicignano dhe Drejtorin e Departamentit të Politikave Konkurruese në METE, Bashkim Sykja, gjatë Forumit të Donatorëve të NVM-ve, 6 Qershor 2011



Foto: Diskutime gjatë Forumit të Donatorëve të NVM-ve, 6 Qershor 2011

për Veprim (), dhe Kodit të Sjelljes së BE-së në Plotësimin dhe Ndarjen e Punës në Politikën e Zhvillimit, komuniteti i donatorëve dhe Qeveria Shqiptare janë të angazhuar të harmonizojnë ndihmën dhe ta rradhisin atë ndër prioritetet shqiptare.

Nisur nga Ndarja e Punës mes donatorëve Evropianë, Kooperacioni Italian për Zhvillim njihet si donatori kryesor për zhvillimin e sektorit privat. Ky rol s'është vetëm rezultat i shumave të shpërndara në këtë sektor (rreth 45 milion euro), por edhe i përkushtimit të madh për të mbështetur institucionet shqiptare në përgatitjen dhe zbatimin e planeve efektive, në linjë me rekomandimet evropiane dhe strategjitë kombëtare, që koordinojnë dhe harmonizojnë ndërhyrjet e donatorëve në këtë sektor. Për këtë qëllim, gjatë Forumit të Donatorëve të NVM-ve, Kooperacioni Italian prezantoi një analizë në lidhje me programet në zbatim që mbështesin NVM-të shqiptare. Kjo analizë u bazua në pyetësorët që u janë shpërndurë donatorëve aktivë në Shqipëri. Kemi, nga njëra anë, qëllimin e përgjithshëm për të evidentuar një panoramë të iniciativës së gjithë do-

natorëve, si dhe për të analizuar se si dhe në çfarë shkalle janë të lidhura ndërhyrjet e donatorëve me METE-n në mbështetje të politikave të NVM-ve. Nga ana tjetër, kemi qëllimin specifik për të identifikuar prioritetet që s'janë plotësuar tërësisht nga ndërhyrjet e donatorëve, me qëllim që të shmanget shkeljet.


Sipas informacionit të vjelë nga pyetësorët, tetë donatorë janë aktivë në zhvillimin e sektorit privat, me 17 projekte që mbështesin Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme: Komisioni Evropian, tre institucione financiare, që janë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Botërore dhe KfW, si dhe katër agjenci kombëtare për zhvillim, që janë: Kooperacioni Italian, Bashkëpunimi Zvicëran dhe USAID-i, me një shumë prej 100 milion eurosh, në periudhën 2005 – 2014. Nga këto 17 projekte, 13 janë në zbatim dhe 4 janë në proces për këtë vit.

Duke iu referuar objektivave të METE-s për zhvillimin e NVM-ve, analiza tregon për një nivel të mirë të donatorëve, edhe pse vërehet se ka preferenca përsa u përkjet prioritetëve. Me anë të buxhetit dhe numrit të projekteve, donatorët përgen-

drojnë ndërhyrjet e tyre për zhvillimin e potencialit të NVM-ve dhe përmirësimin e instrumenteve financiarë. Nga ana tjetër, ka disa objektiva specifike që kanë nevojë për më shumë vëmendje nga komuniteti i donatorëve, siç janë: përmirësimi i fuqisë punëtore dhe aftësia e ndërtimit të institucioneve të mikroredivive. Pjesëmarrësit ranë dakord për rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit të donatorëve (ata donatorë që operojnë në të njëjtën fushë ndërhyrjeje) dhe morën në konsideratë analizën, që është ende në proces, si një hap i parë drejt themelimit të një platforme të qendrueshme monitorimi.

Forumi i përfundoi punimet me prezantimin e Programit për Inovacion dhe Zhvillimin e Teknologjisë së NVM-ve të METE-s. Zbatimi i këtij programi strategjik do të përfaqësojë një mbështetje konkrete për NVM-të në procesin e përtëritjes së aseteve teknologjike. Për rrjedhojë, METE u kërkon donatorëve fonde për të mbështetur zbatimin e këtij programi.

Kombet e Bashkuara në Shqipëri prezantojnë Raportin Vjetor 2010



Në Qershor të 2011, Kombet e Bashkuara në Shqipëri prezantuan Raportin e tretë Vjetor të Programit Një OKB në Shqipëri. Raporti thekson rezultatet në të dyja programet dhe procesin e reformave gjatë vitit 2010. Gjithashtu përmban Raportin Administrativ përshkrues dhe financiar të Fondit të Koherencës të Kombeve të Bashkuara. Raporti ka si objekt partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të OKB-së, si dhe donatorët që



Foto: Konferencë për të prezantuar Planin Operativ për Strategjinë Mjedisore, 17 Qershor 2011

kontribuojnë në Fondin e Koherencës. Raporti Vjetor i Programit Një OKB mund të shkarkohet [këtu](#).

Plan Operativ për Strategjinë Mjedisore

Më 17 Qershor 2011, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), në bashkëpunim të ngushtë me Sida-n organizuan një konferencë për të prezantuar Planin Operativ për Strategjinë Mjedisore. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga MMPAU, Ministria e Financave, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, Ministrinë e ndryshme të linjës dhe organizata ndërkombëtare. Konferenca u hap nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Fatmir Mediu dhe Kryetarja e Bashkëpunimit për Zhvillim në Ambasadën Suedeze, Britta Olofsson. Zëvendës ministri i MMPAU-së, Taulant Bino dhe Sekretarja e Përgjithshme, Myrvete Pazaj, ishin moderatorët e kësaj konference, ndërsa u ndoq me interes të veçantë fjala e Kryetares së Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave, Mimoza Dhembli, dhe fjala e Drejtoreshës së Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, Valbona Kuko. Konferenca u mundësoi pjesëmarrësve informacione dhe u diskutua për rezultatet e punës për përgatitjen e Planit Operativ për Sektorin Mjedisor me qëllim hapjen e një Sektori të Gjerë. Plani Operativ do të bëjë që politikën e qeverisë të kthehen në objektiva operative dhe do t'i integrojë ato me re-

alitetet e reja financiare, siç paraqitet në strukturat vjetore dhe shumëvjetore të qeverisë. Kjo mund të shërbejë për qeverinë si bazë për zhvillimin e një sektori për Mjedisin dhe krijimin e një Fondi Mjedisori. Konferenca vuri theksin në rëndësinë e pasjes së një fondi të vetëm tek i cili mund të kontribuojnë donatorët. Zbatimi i këtij plani do të kërkojë angazhimin e të gjithë institucioneve.

Përgatitja e Planit Operativ u mundësua nga qeveria e Suedisë dhe u projektua nën drejtimin e MMPAU-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e linjës, institucionet qeveritare dhe grupet e tjera të interesit. Zhvillimi i mëtejshëm i Planit Operativ për Sektorin e Mjedisit u organizua nëpërmjet analizave, sondazheve dhe seminareve, ku Plani u zhvillua hap pas hapi. Në tetor 2010 dhe në pranverë të 2011 u organizuan shumë seminare. Këto seminare u plotësuan nga aktivitete të tjera, siç janë intervistat me palët e interesuara dhe promovimi i Planit me institucionet e qeverisë, donatorët dhe median.

Konferenca Kombëtare për Qeverisjen Efektive në Zhvillimin e Destinacioneve Lokale Turistike

Më 20 prill, u zhvillua Konferenca Kombëtare për Qeverisjen Efektive në Zhvillimin e Destinacioneve Lokale Turistike, në Korçë, qyteti i aktiviteteve të shumta dhe shtëpia e traditës në Shqipëri. Takimi u ndoq nga BNGj (Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman) në kontekstin e Programit për Promovimin e Punësimit për Zhvillim Ekonomik, në

bashkëpunim me Bashkinë e Korçës dhe OMD-në (Organizata e Menaxhimit të Destinacioneve). Në konferencë morën pjesë bashkitë e Korçës, Shkodrës, Tiranës, Durrësit dhe Pogradecit, si dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) dhe degët rajonale të saj, Universitetet e Shkodrës, Korçës, Durrësit, Tiranës dhe Vlorës, si dhe organizatat ndërkombëtare donatore (BNGj, UNDP, SNV, USAID). Konferenca u hap nga kryebashkiaku i Korçës, Niko Peleshi. Ai shpjegoi filozofinë e re të bashkisë së Korçës për zhvillimin e saj si “Qyteti i Aktiviteteve”, duke e transformuar atë në një vend tërheqës turistik për turistët e huaj dhe vendas. Ideja e më shumë aktiviteteve përfshin industrinë dhe shoqërinë në tërësi, për t’u siguruar qytetarëve dhe vizitorëve një atmosferë festive të paharrueshme gjatë gjithë vitit.

Pjesëmarrësit diskutuan “metodën e grumbullimit” si një mjet për të zhvilluar një sektor turistik të strukturuar dhe të mirë-organizuar. I aplikuar në qarkun e Korçës, një bashkëpunim më i afërt mund të zhvillohej mes bizneseve, Universitetit dhe Bashkisë.

Znj. Matilda Naço, Drejtuese Ekzekutive e AKT-së nënvizoi rëndësinë e një strategjie për marketing në qytetin e Korçës si qytet dhe si qark. Në diskutime u vu theksi në rolin kryesor të marketingut.

UN Women krijon mundësi për OJQ-të lokale dhe zyrtarët qeveritarë në “Buxhetimin përgjegjës gjinor”

Në 9 dhe 10 Qershor 2011, UN Women ftoi përfaqësues të OJQ-ve nga Kukësi, Elbasani, Shkodra dhe Tirana, dhe përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për të marrë pjesë në një seminar dy ditor në Ti-



Foto: Konferenca Kombëtare për Qeverisjen Efektive në Zhvillimin e Destinacioneve Lokale Turistike, mbajtur në Korçë më 20 Prill 2011

ranë për monitorimin e barazisë gjinore në politika dhe buxhete. Për shumë pjesëmarrës, buxhetimi përgjegjës gjinor ishte një fushë e re.

Trajnimi kishte si qëllim rritjen e mundësive për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që të zhvillojnë strategji për të integruar barazinë gjinore në buxhetet e bashkive. Pjesa e parë e seminarit u fokusua në kuptimin e proceseve të politikave dhe buxheteve dhe rolin e organizatave të shoqërisë civile. Trajnuesit theksuan se buxhetet janë instrumente teknikë dhe politikë. Pjesëmarrja në buxhet u jep qytetarëve mundësi shprehjeje në burimet financiare, duke mundësuar më shumë transparencë dhe përfshirje. Pjesëmarrësit diskutuan për ciklet e buxhetit, aktorët dhe aktivitetet që ndikojnë në proces. Trajnimi u fokusua më pas në analizën dhe monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pjesëmarrësit punuan mbi shembuj nga bashkitë në gjithë botën. Ata mësuan rreth treguesve gjinorë dhe mjeteve të tjera të përdorura për monitorimin e barazisë gjinore në buxhetet lokale.

“Ishte emocionuese të mësoje rreth mjeteve praktike për monitorimin e bux-

heteve. Kjo do të na shërbejë për punë tonë të mëtejshme”, tha njëra nga pjesëmarrëset. Trajnimi është pjesë e një strategjie të integruar për të ndërtuar mundësi për qeverinë dhe OSHC-të në Shqipëri që të analizojnë dhe të monitorojnë politikat dhe buxhetet publike nga një perspektivë e barazisë gjinore. Aktivitetet që do të pasojnë do të integrohen në projektet e qeverisë shqiptare, pjesë e Programit për Bashkëpunim “Një OKB” për 2012 – 2016.

Rrjeti i Femrës Sipërmarrëse në qarkun e Korçës

Më 18 Prill 2011, gra sipërmarrëse nga Korça dhe Pogradeci u bashkuan, në një takim të parë për themelimin e Rrjetit të Femrës Sipërmarrëse në Qarkun e Korçës, në përgjigje të një ftese nga Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman, bazuar në strukturën e Programit për Promovimin e Punësimit për Zhvillim Ekonomik. Pjesëmarrësit në këtë takim ishin kryesisht femra që kishin bizneset e tyre. Ideja e përfitimit nga një rrjet i tillë u mbështet nga pjesëmarrësit dhe u sugjerua dhe u radakord që të ndiqeshin hapa të tjerë. Me qëllim që të forcojnë sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, Rrjeti i Femrave Sipërmarrëse do të ndjekë qëllimet e mëposhtme:

- Shkëmbim informacioni dhe përvojash të suksesshme;
- Organizim i aktiviteteve për biznesin, si: konferenca, seminare dhe misione biznesi;
- Lobim për çështje të ndryshme për të përmirësuar klimën e biznesit;
- Mbështetje ndaj anëtarëve për për-



Foto: UN Women - Trajnimi i OJQ-ve lokale - Monitorimi i barazisë gjinore në politika dhe buxhet

mirësimin e kapaciteteve dhe nxitje për të marrë pjesë në rrjet;

- Aktivitete të mundshme të përbashkëta (si llogaritjet) për uljen e kostos;
- Trajnime të mundshme të përbashkëta.

Takimi vazhdoi me prezantimet “Një grua duhet të jetë burrë për të qenë e suksesshme” (psikologu, dr. Guido Strunk dhe një pikëpamje të tijën për situatën e grave sipërmarrëse në Shqipëri) dhe “Çfarë është një rrjet dhe si mund të funksionojë?”. Pjesëmarrësit diskutuan për të mirat që sjell një rrjet i tillë.

- Tre lloje aktiviteteve do të mbështeten nga Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman:
- Informimi dhe komunikimi (nëpërmjet një buletini);
- Përcaktimi dhe organizimi i aktiviteteve të mundshme të përbashkëta (llogaritjet, marketingu...);
- Vlerësimi dhe organizimi i trajnimeve të mundshme dhe seancave edukuese për anëtarët e rrjetit.

Trajnim i PAMECA III për Menaxhimin e Kufijve në procedurat e Vlerësimit të Schengen-it

Në mënyrë që të vihen në zbatim Standartet Schengen, është e nevojshme që Autoritetet respektive shqiptare të Menaxhimit të Kufijve (Policia kufitare dhe emigracionit dhe Administrata e Doganave) të kenë mundësinë të vlerësojnë zbatimin e Standardeve të kërkuara



Foto: Takim për themelimin e Rrjetit të Femrës Sipërmarrëse në qarkun e Korçës, organizuar më 18 Prill 2011

Schengen dhe të jenë të përgatitur profesionalisht për t’iu përgjigjur kërkesave të BE-së për të vlerësuar gatishmërinë në këtë pikë. Kështu, u mbajt një seminar katër ditor nga një Ekspert Afat Shkurtër (Vlerësues dhe Trajnues i certifikuar i Schengen-it), në mënyrë që të përgatisë fazën e parë të zbatimit të procedurave të vlerësimit dhe standardeve. Një trajnim i mëtejshëm është planifikuar për në vjeshtë të 2011-ës, ku autoritetet shqiptare dhe pjesëmarrësit do të jenë në rolin e vendit të vlerësuar dhe vlerësuesit, në mënyrë që të fitojnë përvojë. Instruktor në këto kurse ishte z. Kurt Pilwax, i cili u ftua dhe u mbështet nga PAMECA III.

14 pjesëmarrësit shprehën vlerësimin e tyre për njohuritë dhe përvojën që fituan nga trajnimi dhe për bashkëveprimin efektiv me anëtarët e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare. Kjo u lejoi të kuptonin rëndësinë e procesit të Vlerësimit, si dhe procedurat e zbatimit të Standardeve Schengen.

Konferenca Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 1 Qershor 2011

Me rastin e 1 Qershorit, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta organizoi Konferencën Kombëtare të të Drejtave të Fëmijëve: “Tani mund të di, të marr pjesë dhe të mbrojt veten”. Kjo ngjarje u mbështet nga UNICEF, Fondi Save the Children dhe organizata të tjera. Konferenca vinte theksin në rëndësinë e ligjit të miratuar së fundmi “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”. Ligji është bërë pjesë e legjislaturës vendase, pasi është marrë nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve. Ai rrit vëmendjen ndaj të drejtave të fëmijëve, përmes detyrimit kushtetues dhe i vë autoritetet nën përgjegjësinë e monitorimit të zbatimit të tij në nivel kombëtar dhe rajonal. “Është e papranueshme që një fëmijë, vetëm se është lindur nga prindër të varfër, të ketë më pak mundësi në jetë se një fëmijë që ka prindër të pasur. Të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësi të mira në jetë. Shumë prova dëshmojnë se shoqëri të tilla kanë rezultate më të mira në rritjen ekonomike, uljen e varfërisë, kontrollin e krimeve dhe dhunës, uljen e stresit dhe shtimin e kënaqësisë së qytetarëve.”, tha Detlef Palm, përfaqësues i UNICEF-it në Shqipëri. “Fëmijët janë çelësi i uljes së varfërisë; le t’i ndihmojmë që varfëria të mos kalojë nga një brez në tjetrin dhe që të gjithë fëmijët të kenë shanse të barabarta.”

Panairi i Fëmijëve më 1 Qershor 2011

Me rastin e Ditës së Fëmijëve, më 1



Foto: Pjesëmarrësit e PAMECA-s në Trajnimin për Vlerësimin e Schengen-it, Qershor 2011

Qershor 2011, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me ndihmën e UNICEF-it organizuan Panairin e Fëmijëve në Pallatin e Kongreseve. Znj. Liri Berisha, Zëvendës Ministra e Arsimit dhe Shkencës, Nora Malaj, Përfaqësuesi i UNICEF-it, Detlef Palm dhe kryetari i Dhomë së Tregtisë dhe Industrisë, Nikolin Jaka dhe përfaqësues të shkollave, bizneseve, përfshirë mësues dhe fëmijë, morën pjesë në ceremoninë e hapjes. Ky panair u bë për të ndihmuar prindërit, zyrtarët, shkollat dhe komunitetet për të pasur një perspektivë më përfshirëse në kujdesin ndaj fëmijëve, për t'i mbrojtur dhe për të krijuar një ambient stimulues për ta. Panairi mbledhi bashkë biznese private dhe projektues për përfshirjen e fëmijëve më në nevojë. Kjo rihorcoi përgjegjësinë sociale për bashkëpunim mes bizneseve në Shqipëri. Gjatë fjalës së hapjes, z. Palm theksoi se “është gjë e zgjuar që të investohet tek fëmijët, sepse ata kanë çelësin e uljes së varfërisë. Të gjithë mund të kontribuojmë për një shoqëri më të mirë: politikëbërësit, agjencitë për zhvillim, bota e biznesit, punonjësit civilë, mësuesit, dhe sigurisht, fëmijët - përfshirë edhe ata që janë më pak të privilegjuar dhe ata që kanë nevojë për më shumë ndihmë se disa të tjerë.”

Policia e Shtetit, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe UNICEF mbështesin “fëmijët e humbur” në Shqipëri

Më 7 Qershor 2011, QMDF në Shqipëri për ALO 116 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me UNICEF Albania nënshkruan një marrëveshje për përmirësimin e bashkëpunimit në gjetjen e fëmijëve të humbur në Shqipëri. Numri Telefonik – i njohur edhe ne Evropë për fëmijët e humbur “116 000, përdoret gjithashtu edhe në Shqipëri në linjën për ndihmë “ALO 116”, e cila u shërben prindërve, autoriteteve gjyqësore dhe atyre të rendit, medias dhe publikut për të ndihmuar në situata emergjente.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, z. Burgaj ofroi mbështetjen e tij institucionale dhe publike. Drejtori i QMDF-së, z. Hazizaj falënderoi gjithashtu të gjithë prindërit që ndihmuar. “Më vjen mirë që bashkëpunimi i suksesshëm mes QMDF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pol-



■ Foto: Më 7 Qershor 2011, QMDF në Shqipëri për ALO 116 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në bashkëpunim me UNICEF Albania nënshkruan një marrëveshje për të përmirësuar bashkëpunimin në gjetjen e fëmijëve të humbur në Shqipëri

icisë e bëjnë Shqipërinë të jetë një shembull i mirë për shumë vende të rajonit”, tha z. Detlef Palm, përfaqësues i UNICEF Albania. Ai theksoi se bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore është i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e plotë të fëmijëve në rrezik.

Gjatë këtij viti, ALO 116 u njoftua për pesë fëmijë të raportuar të humbur. ALO 116 dhe QMDF po bashkëpunojnë me autoritete të vendeve të tjera për të gjetur Bleona Matën. Sipas ALO 116-së, rreth 4 % e fëmijëve – kryesisht mes moshës 14 dhe 18 vjeç – besojnë se të largohesh nga shtëpia mund të jetë një zgjidhje për problemet e tyre. Si një nga anëtarët e reja të Rrjetit Global për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar, Linja Shqiptare e Ndihmës për Fëmijët, në bashkëpunim me UNICEF, QMDF dhe mbështetës të tjerë, ranë dakord të aktivizojnë numrin 116-000, një numër i njohur në mbarë Evropën për Fëmijët e Humbur në Evropë. Ky shërbim do të ofrojë këshillim psikologjik për fëmijë të dhunuar dhe të humbur, fëmijë të trafikuar ose për ata që largohen nga shtëpia. Prindërit do të ndihmohen në mënyrat më të mira në çastet delikate. Nënshkrimi i marrëveshjes në mbështetje të ALO 116 000 është një hap i madh drejt forcimit të ndihmës së ofruar nga shërbimet e emergjencës në mbarë Shqipërinë në rastet e fëmijëve të humbur.

Pasoja të kequshqyerjes dhe pasigurisë së ushqimeve

Më 8 Qershor 2011, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së

Bujqësisë, Institutit të Shëndetit Publik, Institutit Rajonal Shëndetësor Kukës, Autoriteteve të Ushqimit dhe Bujqësisë, Agjencive të OKB-së dhe partnerëve të shoqërisë civile u mbledhën në Kukës për një seminar mbi luftën ndaj kequshqyerjes dhe pasigurisë së ushqimeve në grupe të mëdha të rrezikuara. Kjo iniciativë ndërsektoriale mbështetet nga UNICEF, OBSH dhe OUB nëpërmjet Programit të Përbashkët për Sigurinë e Ushqimit dhe Ushqyerjen e Fëmijëve. Programi financohet nga Qeveria e Spanjës nëpërmjet Fondit MDG. Ky eveniment u drejtua nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik të Qarkut Kukës. Z. Martini deklaroi se “Qarku i Kukësit ka një sërë problemesh me shëndetin lidhur me gratë shtatzëna, nënat dhe fëmijët, me nivele të larta të kequshqyerjes dhe anemisë... Unë jam optimist për këtë ndërhyrje... Janë bërë diskutime me popullsinë në zona të ndryshme... Është bërë një vlerësim për praktikën e ushqyerjes, shkaqet e anemisë dhe problemet me sigurinë e ushqimeve”. Drejtori i Shëndetit Publik, Gazmend Bejtja tha: “Për çdo dollar të investuar në ushqyerje, fitohen katër dollarë. Kostoja financiare e kequshqyerjes llogaritet deri në 0.7 % të GDP-së (Prodhimit të Brendshëm)”. Kryetarja e Koordinimit dhe Publikimit në Ministrinë e Bujqësisë, Eriola Furxhi shtoi: “Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ne besojmë se çdo njeri ka jo vetëm të drejtën e ushqimit të mjaftueshëm, por edhe të ushqimit të shëndetshëm dhe të sigurt. Ne shpresojmë që ky program të hedhë themelet për të bërë politika më të mira.”

Znj. Daniela Nika nga Departamenti i Shëndetit në Institutin e Shëndetit Pub-

lik theksoi: “Ne kemi studiuar shkallën e njohurive, sjelljet dhe besimin e punonjësve të qendrave shëndetësore kudrejt praktikave dhe zakoneve të ushqyerjes të popullsisë në përgjithësi. Modulet e trajnimit për punonjësit e qendrave shëndetësore janë përgatitur për të rritur njohuritë e tyre në praktikat e ushqyerjes dhe në kontrollin e rritjes së fëmijëve”. Duke parë boshllëkun në nivelin e mikroelementeve brenda ushqyerjes së përditshme të popullsisë, një tjetër iniciativë e rëndësishme është pasurimi i detyruar i miellit. Gjithashtu, do të shtohet Kurrikula e Ushqyerjes në programin akademik të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës; dhe do të krijohet një sistem më i konsoliduar informativ për statistikën e sigurisë së ushqimit dhe ushqyerjes në Shqipëri, e bashkë me të do të përgatitet edhe një sistem monitorimi. Znj. Nika përfundoi: “Sfida për ne si staf mjekësor është të bëjmë përmirësimet e nevojshme në nivelin e ushqyerjes të gratë dhe fëmijët, çka do të ulte vdekshmërinë, pjesë e përkushtimeve tona për Qëllimet për Zhvillim të Mijëvjeçarit.”

Programi i Përbashkët është realizuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, INSTAT, institucionet e specializuara, autoritetet rajonale dhe organizatat e shoqërisë civile, me mbështetje nga UNICEF, OBSH dhe OUB



■ Foto: Përfaqësues të qeverisë qendrore dhe lokale, partnerë lokalë dhe të projekteve në qarkun e Shkodrës dhe Lezhës u takuan në Shkodër më 15-16 Qershor 2011 për të kontribuar në seminarin e Programit për Zhvillim Rajonal për Shqipërinë Veriore

Seminar i Programit për Zhvillim Rajonal i Shqipërisë Veriore

Më 15 dhe 16 Qershor 2011, mbi 50 përfaqësues nga qeveria qendrore dhe lokale, partnerë lokalë të projekteve në qarkun e Shkodrës dhe në qarkun e Lezhës u mbledhën në një seminar për Programin për Zhvillimin Rajonal (PZHR). Seminari dy ditor ishte një pjesë e rëndësishme e Fazës së Fillimit. Qëllimi ishte të testohet terreni mbi të cilin ngriheshin hipotezat dhe të projektoheshin mënyrat më efektive për t'u marrë me çeshtje që janë pjesë e programit. Me një metodë mbështetëse, PZHR-ja përfundoi një sërë vlerësimesh për: planifikimet lokale dhe rajonale; fondet për zhvillimin rajonal; barazinë gjinore; varfërinë; organet institucionale; planin NUTS II në Shqipëri; PRZH-në dhe qarqet e Shkodrës dhe Lezhës. Konkluzionet dhe rekomandimet e vlerësimeve u prezantuan dhe u diskutuan në seminar. Përfuturit

e programit patën mundësinë të rekomandojnë gjatë seminarit një varg aktivitete që do të ndërmerren në tre vjet e gjysmë që mbeten nga programi, çka do të çonte në arritjen e Rezultateve të Pritshme të programit. Kjo është veçanërisht e vërtetë për rekomandimet që lidhen me çeshtjet e metodave me shumë nivele, si: mënyra e drejtimit të çeshtjeve të gjinisë dhe varfërisë; strukturimi i Fondit të PZHR-së; zhvillimi institucional (i cili përforcon rolin e Qarqeve dhe krijimin e një Agjencie për Zhvillimin Rajonal më të fortë); dhe aftësia për të ndërtuar strukturat e lartpërmendura.

Aktiviteti u hap nga Kryetari i Zyrës së ADA-s, Astrid Wien, kryetari i Këshillit Rajonal të Shkodrës, Gjovalin Kolombi, Prefekti i Shkodrës, Maxhid Cungu dhe Zëvendës kryetari i Këshillit Rajonal të Lezhës, Gjovalin Gjeloshi. Zëvendës Ministri i Brendshëm, Ferdinand Poni theksoi se këshillat rajonale dhe Ministria e Brendshme janë partnerë në procesin e zhvillimit dhe decentralizimit. Ndërsa përipiqen për të përbushur rolin e tyre në proces, pritet që këshillat ra-

jonale të luajnë një rol më të madh në zhvillimin rajonal.

Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjerman shpall fituesit e “Programit për Rrjetin e Biznesit Krijues”

Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjerman do të mbështesë pesë nga 33 projekte të përzgjedhura nga një juri e përbërë nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Janë dorëzuar shumë projekte të mira dhe tani, projektet që do të përzgjidhen do të ndajnë një grant prej 60.000 eurosh dhe do të vënë në zbatim aktivitetet e tyre në Nëntor 2011. Qëllimi kryesor i thirrjes së parë për konkurrim ishte mbështetja e rrjeteve ekzistuese, federatave dhe organizatave të ekonomisë krijuese për të rritur profesionalizmin dhe aftësitë konkurruese të anëtarëve të saj.

Një nga projektet fituese që u dorëzua

ishte një projekt i përbashkët nga Fondi Kombëtar i Monumenteve dhe Shoqëria e Arkitektëve. Projekti “Qytetet e qeshura” ishte i vetmi projekt arkitekturor në garë. Ai kishte si qëllim rinovimin dhe promovimin e imazhit të hapësirave publike në zona urbane të Tiranës. Juria u habit gjithashtu nga një tjetër fitues - Organizata e Menaxhimit dhe Destinacionit nga Korça. Projekti “Çantat e lumtura” përfshin 20 gra artizane të cilat do të prodhojnë një koleksion çantash me forma, ngjyra dhe përmasa të ndryshme, me qese plastike të riciklueshme. Ndër fituesit e tjerë ishte Organizata e Ruajtjes dhe Zhvillimit e Gjirokastrës e cila do të krijojë 15 produkte moderne në bashkëpunim me një stilist mode dhe 10 artizanë. Do të përfshihet edhe restaurimi i pjesës së brendshme të dyqaneve artizanale. Si dhe Fondacioni Rozafa, i cili do të themelojë një rrjet krijuesish të ndryshëm, që do të prodhojnë dhe promovojnë aksesorë mode.

Duke përmirësuar kapacitetet prodhuese, duke përdorur materiale të prodhuara në Shqipëri dhe duke u trajnuar për zhvillimin e produkteve, aktorë të ndryshëm do të punojnë së bashku, duke i shtyrë kështu stilistët, punëtorët e punës me dorë dhe partnerët në tregti drejt një niveli tjetër.

Financuar nga qeveria gjermane, BNGj mbështet Shqipërinë në promovimin e ekonomisë krijuese. Në 2010, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës mori iniciativën për të vlerësuar ekonominë krijuese në Shqipëri, bashkë me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me ndihmë teknike nga Ministria gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi, u zhvillua një program strategjik i promovimit të biznesit, duke përfshirë tre nën-programe me target-grupe të orientuara. Njëri prej tyre ishte thirrja për konkurrim i BNGj-së, “Programi për Rrjetin e Bizneseve Krijuese”.

Banka Botërore mbështet barazinë gjinore për fuqizimin e grupeve të mënjanuara dhe në rrezik në Shqipëri

Më 23 Qershor 2011, Zyra e Bankës Botërore në Tiranë shpalli fituesit e Fondit për Shoqërinë Civile për 2011. Fokusi i programit për këtë vit është *barazia*



■ Foto: Seanca e përzgjedhjes së fituesve të “Programit për Rrjetin e Biznesit Krijues” nga juria e BNGJ-së, më 23 Qershor 2011

gjinore, veçanërisht për fuqizimin e grupeve të rrezikuara dhe të mënjanuara në Shqipëri. Projektet e mbështetura do të promovojnë: zhdukjen e pabarazive të kapitalit njerëzor, mundësitë e arsimimit, mundësitë për mbrojtje sociale, dhe shërbimet shëndetësore; zhdukjen e pabarazive në mundësitë socio-ekonomike, tregun e punës, të drejtat e pronës; fuqizimin e rolit të gruas, sidomos grave të grupeve të mënjanuara, grave me aftësi të kufizuara, grave rome, në iniciativat për zhvillim në komunitetet e tyre dhe në vendim-marrjet lokale; ndërgjegjësimin gjinor dhe ndryshimet në mendësi për kontributin e grave; lidhjet gjinore që përfshijnë të rinjtë, burrat dhe djemtë në aktivitete të ndryshme; mbrojtjen dhe monitorimin e vënies në zbatim të legjislacionit të lidhjeve gjinore; ndërgjegjësimin komunitar për barazinë gjinore dhe dhunën në familje; përfshirjen e burrave dhe djemve në luftën ndaj stereotipeve gjinore, diskriminimit dhe dhunës ndaj grave.

Rreth 60 projekt-propozime u morën dhe u analizuan nga Komiteti i Vlerësimit të Jashtëm në të cilin bënin pjesë përfaqësues nga komuniteti i donatorëve dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë me programe të shoqërisë civile si edhe stafi i Bankës Botërore. Shuma totale për programin e këtij viti është 60 000 dollarë amerikanë dhe shpërndarja gjeografike mbulon gjithë rajonet e vendit. Për të parë 60 projektet, ju lutem klikoni këtu.

Konferenca mbi Projektin e Reformave për Forcimin e Lidhjeve në Ballkan

Projekti i Reformave për Forcimin e Lidhjeve në Ballkan është financuar nga qeveria e Mbretërisë së Vendeve të

Ulëta që në 2007. Projekti është zbatuar nga Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (QBLN), Unioni Ndërkombëtar i Drejtësisë (UND) dhe Fondi i Hapur Rajonal i Evropës Juglindore Reformë Ligjore nga Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman. Në mënyrë që të vlerësoheshin Rezultatet Paraprake dhe Sfidat për të Ardhmen e Reformave për Sistemet e Zbatimit të Ligjit në Evropën Juglindore, 40 ekspertë, bashkë me homologët e tyre nga projekte të Evropës Jugperëndimore (Përfshirë 6 nga Shqipëria), disa përfaqësues nga QBLN, BNGj dhe UND dhe të ftuar nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta u mblodhën së bashku në kryeqytetin ligjor të botës, Hagë, për të paraqitur rezultatet e tyre dhe për të diskutuar mbi perspektivat e së ardhmes.

Qëkurse miratoi ligjin nr.10031 më 11.12.2008 për Shërbimin Privat të Përmbartimit, Shqipëria ka zhvilluar një sistem dy drejtimesh: konsumatori mund të zgjedhë mes një agjenti privat përmbartimi dhe një agjenti shtetëror. Që nga Tetori 2010, kanë filluar punën mbi 60 agjentë privatë përmbartimi. Projekti i RFLB-së ka punuar për vënien në zbatim të ligjit nr. 10031 duke ndihmuar në:

- zhvillimin e çdo rregullatori që është i nevojshëm, në mënyrë që të kryhen provimet (bashkë me Euralius II),
- organizimin e provimeve,
- themelimin e një dhome agjentësh përmbartimi në Tetor 2010,
- drejtimin e trajnimit për vlerësimin dhe shpalljen e një konkursi për kurrikulën,
- ofrimin e seancave të trajnimit për agjentët e parë privatë të përmbartimit, p.sh. në sistemimin e zyrës, aftësitë drejtuese,
- krijimin e rregullatorëve në lidhje

me faturat,

- krijimin e një kodi etike.
-
- Nga ekspertët dhe nga QBLN, BNGj dhe UND u krijua një hartë e rrugëve në nivel rajonal. Të njëjtët ekspertë zhvilluan gjithashtu dy manuale: një për monitorimin dhe kontrollin dhe një për transparencën e aseteve.

Për më tepër, u botua një libër për “Zbatimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor”.

Libri përmban gjithë informacionin që është grumbulluar dhe sistematizuar gjatë tre viteve të fundit brenda rajonit. Disa kopje falas, në anglisht, gjenden akoma në Zyrën e Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Reforma Ligjore, Rruga “Skenderbej”, Pall 4 ap 10, Tiranë – Shqipëri, tel: 2233374, orflex-al@giz.de.

Një arkitekt zviceran me Bashkëpunimin Gjerman për Zhvillim

Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim dhe Agjencia Zvicerane SYNI 21 (financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çeshtjet Ekonomike dhe Këshilli Bashkiak i Lozanës) bashkëpunuan në zhvillimin e turizmit në qarkun e Korçës. Një arkitekt zviceran, Mikail Broger, kaloi gjashtë muaj duke mbështetur bashkinë e Korçës në zhvillimin e shtëpive pritëse të rinovuara dhe të një fshati të ri turistik, si dhe riparimin e shtëpive tradicionale me potencial turistik në fshatin e Vithkuqit. Transformimi i shtëpive tradicionale në shtëpi pritëse në



Foto: Konferenca e PRFLB në Hagë, Qershor 2011

fshatin e Vithkuqit përfshin: identifikimin e shtëpive pritëse për t’u riparuar; planifikimin e zgjidhjeve të mëtejshme; vlerësimin e shpenzimeve. Për rindërtimin e restorantit në qendrën e fshatit, do të ndërtohet një projekt rehabilitimi, duke iu përgjigjur veçantive mjedisore të fshatit. Do të krijohet dhe botohet një fletëpalosje, “Parimet e Praktikës së Ndërtimit të Mirë”.

Bateritë e Përdorura Plumb Acid – një sfidë për menaxhimin mjedisor në Shqipëri

Më 7 Qershor 2011, Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) organizoi konferencën “Bateritë e Përdorura Plumb Acid – një sfidë

për menaxhimin mjedisor në Shqipëri”. Kjo ngjarje ishte përmbyllja e një projekti dy vjeçar për “Uljen e rrezikut për shëndetin dhe mjedisin në Shqipëri nga bateritë e përdorura plumb acid”, financuar nga BE nëpërmjet programit CARDS 2006. Ngjarja u mirëprit nga zëvendës Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, Taulant Bino, i cili theksoi rëndësinë e projekteve të tilla dhe kontributin e shoqërisë civile për të përmirësuar legjislacionin në vend. Z. Antoine Avignon, Menaxher i Sektorit Mjedisor, në Delegationin e BE-së në Shqipëri bëri një përmbledhje të shkurtër të legjislacionit të BE-së në lidhje me Bateritë dhe Akumulatorët. Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e projekteve të tilla, ku kërkimi dhe puna studimore kombinohen natyrshëm edhe me përgjegjëshmërinë e grupeve të ndikuara. Prezantimi i zbulimeve të projektit dhe reflektimi i mundshëm mbi vendimet e Këshillit të Ministrave mbi bateritë dhe akumulatorët u prezantua nga Ennio Haxhimihali. Analizat e aspekteve pozitive dhe negative nxitën debate të gjata mes pjesëmarrësve. Znj. Lediana Xhakollari foli për perceptimin e grupeve të ndikuara për rrezikun e mundshëm të shëndetit dhe nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarëve apo grupeve që merren me grumbullimin dhe riciklimin e baterive. Konferenca u mbulua nga media, për rëndësinë ligjore dhe shëndetësore të çeshtjes.

Takim i Praktikës së Buxhetit Komunitar (PBK) të MSHP MNG në Minsk, Bjellorusi

Menaxhimi i Shpenzimeve Publike dhe



Foto: Arkitekti i ri zviceran, Mikail Broger, kaloi gjashtë muaj duke mbështetur bashkinë e Korçës në zhvillimin e shtëpive pritëse të rinovuara dhe të një fshati të ri turistik, si dhe riparimin e shtëpive tradicionale me potencial turistik në fshatin e Vithkuqit.

rrjeti i Mësimet me Ndhimën e Kolegëve përfaqëson një përpjekje të shumanshme për të zhvilluar mundësitë dhe për të ndarë përvojat e reformave mes vendeve të Evropës lindore dhe Azisë qendrore. Profesionistë nga këto vende diskutojnë sistemet e tyre të menaxhimit të shpenzimeve publike dhe mësojnë nga përvoja e kolegëve, në mënyrë që të rrisin njohuritë e tyre. Nga 14 deri 17 Qershori 2011, u organizua në Minsk një takim tre ditë e gjysmë mbi reformat. Seminari ishte një kombinim prezantimesh, diskutimesh të hapura dhe seancash përmbyllëse. Praktikantë nga 19 vende MSHP MNG (Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Kazakistani, Republika e Kirgistanit, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Taxhikistani, Turqia, Ukraina dhe Uzbekistani) folën për temat e mëposhtme: si ka ndikuar kriza financiare në buxhete në shumë vende MSHP MNG; si kanë ndikuar dobësitë në organizim dhe mungesa e rregullave për zgjidhje efikase në procesin e krijimit të buxhetit; si po bëhet gjithnjë e më shumë përcaktues roli i Ministrisë së Financave dhe Ministrive të tjera të linjës; si duhet t'u referohet kapitali i një buxheti shtyllave bazë.

Prezantimi i Shqipërisë i titulluar "Rëndësia e planifikimit strategjik në programimin dhe buxhetit dhe prioritetet" u fokusua kryesisht në lidhjen mes planifikimit strategjik dhe procesit të krijimit të buxhetit. Përfaqësuesja Shqiptare, znj. Florensa Haxhi, koordinatore e DEBAS-KON-it ndau me vende të tjera përvojën



■ Foto: Konferenca "Bateritë e përdorura Plumb Acid – një sfidë e menaxhimit mjedisor në Shqipëri", organizuar më 7 Qershor 2011

e Shqipërisë në zbatimin e suksesshëm të Sistemit të Planifikimit të Integruar.

BE mbështet luftën kundër pastrimit të parave në Shqipëri

Më 23 Qershor 2011, BE prezantoi projektin e ri prej 1.5 milion eurosh në mbështetje të luftës së Shqipërisë kundër pastrimit të parave. Dy partnerët, Instituti spanjoll i Studimeve Fiskale dhe Departamenti bullgar i Intelgjencës Financiare do të ndihmojnë autoritetet shqiptare në përmirësimin e zbatimit të Ligjit Anti-Mafia dhe neneve të tij, duke ofruar ekspertizën e shteteve anëtare në gjetjen, hetimin dhe ndjekjen penale të personave që pastrojnë para; në konfiskimin dhe administrimin e aseteve krim-

inale; dhe në koordinimin efektiv mes agjencive të zbatimit të ligjit. Projekti do të ndihmojë autoritetet shqiptare për të kapërcyer sfidat e hetimit dhe ndjekjes penale të çështjeve duke: 1. përmirësuar procedurat e punës dhe teknikat e hetimit që përdorin prokurorët dhe Policia shqiptare në gjetjen, hetimin dhe ndjekjen penale të pastruesve të parave; 2. rritur mundësitë për Policinë e Krimit Financiar për të analizuar informacionin që vjen nga Raportet e Operacioneve të Dyshimta; 3. mbështetur Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Konfiskuara, që të zhvillojë procedurat për administrimin dhe nxjerrjen në ankand të pasurive të konfiskuara; 4. vendosur procedura standarde operative për shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin mes Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, institucioneve të gjyqësorit, agjencive e taksave dhe doganave, Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë dhe 5. fuqizuar bashkëpunimin me aktorë ndërkombëtarë dhe rajonalë, si Interpoli dhe Evropoli.

Gjatë ceremonisë së prezantimit, Kryetari i Delegationit të BE-së në Tiranë, Ambasadori Ettore Sequi theksoi rëndësinë e stabilitetit dhe bashkëpunimit mes agjencive të zbatimit të ligjit për zbatimin me sukses të këtij projekti, si dhe rëndësinë e luftës efektive ndaj krimit të organizuar. Ambasadori Sequi vërejtë se "Kërkohet përkushtimi i shumë agjencive, sidomos i Prokurorisë, Policisë së Shtetit dhe Njësisë të Krimit Financiar. Është përgjegjësi e tyre që të përfitojnë nga këto trajnime dhe ekspertiza, të sigurojnë qëndrueshmëri mes stafit dhe të arrijnë kësaj rezultate në luftën kundër krimit të organizuar. Është përgjegjësi e tyre që të bashkëpunojnë për t'i arritur këto rezultate". Ai thek-



■ Foto: Koordinatorja e Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhimës së Huaj, Florensa Haxhi duke bërë prezantimin e punimit "Rëndësia e planifikimit strategjik në programimin dhe prioritetet e buxhetit" gjatë takimit të MSHP-së

soi nevojën për një legjislaturë që lufton krimin e organizuar. “Kjo tregon”, shtoi ai, “se vullneti politik, vizioni i përbashkët dhe vendosmëria e veprimit u tregojnë qytetarëve të ndershëm dhe kriminelëve se krimi paguhet”.

Projekti i financuar nga BE-ja dorëzon një version të përmirësuar të Kodit Doganor Shqiptar

Më 14 Qershor 2011, ekspertë austriakë dhe polakë të cilët morën pjesë në modernizimin e doganave shqiptare si pjesë e një projekti të përbashkët prej 2 milion eurosh, financiar nga BE-ja, dorëzuan një propozim për Kodin Doganor shqiptar. Kodi i Ri është rezultat i një analize të detajuar të legjislacionit shqiptar dhe evropian me qëllim që të thjeshtëzohen procedurat doganore për tregtarët shqiptarë dhe të huaj. Kodi i Ri përmirëson procesin e integritetit duke bërë që Shqipëria të ketë të njëjtat procedura me BE-në në tregti, çka ka sjellë dhe suksesin e Tregut të Brendshëm. Në bashkërendim mes autoriteteve shqiptare, Administratës së Doganës austriake dhe me mbështetjen e Shërbimit Doganor polak kanë ardhur dy ekspertë nga shtetet anëtare të BE-së. Ata do të ndihmojnë në plotësimin e legjislacionit shqiptar në një linjë me atë të BE-së, për të vënë në zbatim Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Kufijve dhe në përgatitjen e Shqipërisë për aderim në Konventën e Tranzitit të Përgjithshëm.

Me këtë rast, Kryetari i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ambasadori Ettore Sequi theksoi se harmonizimi i procedurave doganore është kyçi i suksesit të Tregut të Brendshëm të BE-së, duke krijuar një mjedis për biznesin për parashikueshmëri dhe besim. Ai vëren se procedurat e harmonizuara doganore krahasohen me lëvizjen e lirë duke u sjellë përfitime qytetarëve. “Harmonizimi i procedurave doganore”, shtoi ai “do të thotë parashikueshmëri, besim dhe efikasitet për biznesin”. Me fjalë të thjeshta, do të thotë një tregti më e zbutur. Për Shqipërinë, harmonizimi i këtyre procedurave me ato të BE-së do të thotë të përjetosh integritetin e BE-së në kushte të prekshme. Do të thotë të bëhesh pjesë e një tregu të gjerë, ku rregullat e lojës njihen dhe respektohen”. Projekti 2 milion eurosh do të vazhdojë deri në Janar të 2012 dhe do të vihet në zbatim nga Administrata Austriake e Doganave edhe me mbështetjen e Shërbimit Doganor Polak.

HISTORI SUKSESI

Muzika bëhet Terapi për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Zyra e Bashkëpunimit Zviceran mbështet Shqipërinë në përpjekjet e saj drejt integritetit evropian duke dhënë ndihmesën në përmirësimin e qeverisjes dhe shtetit ligjor dhe konkurrencës ekonomike. Trajnimi në pedagogjinë speciale dhe ndihmesa ndaj personave me aftësi të kufizuara kanë qenë elemente të rëndësishme të ndihmesës zvicerane për përfshirje më të madhe sociale në Shqipëri



Foto: Fëmijët me aftësi të kufizuara bëjnë terapi me muzikë nëpërmjet punës së Pëllumb Legisit

Në Shqipëri ka qenë gjithmonë traditë që njerëzit me aftësi të kufizuara të distancoheshin dhe të trajtoheshin si “të sëmurë”. Për më tepër, për vite të tëra kanë munguar mësuesit dhe kujdestarët e specializuar. Bashkëpunimi Zviceran është përpjekur për të promovuar përfshirjen në shoqëri të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Prandaj ata hartuan një projekt që kishte për qëllim trajnimin e specialistëve dhe pedagogëve për personat me aftësi të kufizuara dhe themelimin e një pedagogjie speciale në nivel universitar.

Pëllumb Legisi e vuri jeta përballë një dileme, kur iu paraqit shansi për të punuar në sektorin e fondit zviceran të pedagogjisë Speciale në Universitetin e Vlorës. A mund të punonte ai me persona me aftësi të kufizuara? Ai kishte studiuar vetëm muzikë dhe kishte punuar si një animator grupi në qendrën Don Bosko, duke drejtuar një grup fëmijësh që mermin pjesë në aktivitete shoqërore. Ai vendosi ta pranonte këtë sfidë dhe të hynte në konkurs. Nga 100 kandidatë, 20 u pranuan në fakultetin e sapohapur dhe Pëllumbi ishte njëri prej tyre.

“M'u drodh zemra kur pashë fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, rrëfen Pëllumbi, kur kujton përvojën e tij të parë në shkollë. “Për rreth dy javë, isha konfuz dhe mendoja të hiqja dorë. Fatmirësisht, kisha një mik timin, student, dhe ne inkurajonim njëri-tjetrin, kështu që qëndrova”, shton Pëllumbi. Më pas, kurrikula e shkollës i qe kushtuar e gjitha pedagogjisë speciale dhe u drejtohej njerëzve me aftësi të kufizuara, por ku

përfshiheshin edhe lëndë si matematika, fizika dhe psikologjia.

Megjithatë, arritja më e madhe për Pëllumbin erdhi më vonë, gjatë kursit. Kur një trajnues zviceran i prezantoi mjetet se si të përdorej muzika si terapi, atëherë erdhi çasti i së vërtetës për Pëllumbin. Ai e kuptoi se njohuritë e tij muzikore

s'do të shkonin dëm, por mund të përdroreshin si një mjet i vlefshëm në vokacionin e tij të ri. Në vitin e tretë të studimeve, ai filloi t'u bashkëngjiste muzikën aftësive të reja që kishte marrë. Rezultati ishte një terapi e re me muzikë e cila u testua në disa raste.

“Unë e quaj shprehje muzikore”, thotë Pëllumbi me modesti. “E shoh ndikimin pozitiv që ka te njerëzit me aftësi të kufizuara, por unë s'e quaj terapi”.

Pëllumb Legisi

Sipas Pëllumbit, edhe matematika mund të mësohet duke përdorur ritmet muzikore dhe tingujt. I pajisur me një diplomë për Pedagogji Speciale, Pëllumbi u punësua nga Instituti i Fëmijëve me Dëgjim të Dobët. Por jashtë orëve të tij të punës, ai jepte shërbime terapie muzikore për fëmijë dhe të rritur. Disa fëmijë me aftësi të kufizuara jo serioze mësuan të luanin instrumente muzikore, siç janë kitarra dhe organoja.

“Tani mund të paguhem për këtë shërbim”, përfundon Pëllumbi. “Por ka shumë raste kur e bëj vetëm se më pëlqen të ndihmoj”. Ai vëren se është rritur kërkesa për këtë shërbim dhe dëshira e prindërve dhe familjeve për të paguar. Me ose pa pagesë, ai nuk pendohet që ka marrë vendimin për të studiuar në fakultetin e Pedagogjisë Speciale.

“Studimi në fakultetin e Pedagogjisë Speciale më ka mundësuar që të gjej punë. Por gjithashtu më ka dhënë mundësinë t'i përdor mësimet e mia në muzikë dhe t'i kombinoj ato si terapi për personat me aftësi të kufizuara.”

BANKA BOTËRORE

Qeverisja e Propozuar Programatike dhe Huaja e Politikave të Zhvillimit dhe Rritjes (PDPL), Mision Para-Vlerësues, mbajtur nga 21 deri 29 Qershor 2011-08-18

Qëllimet e misionit ishin: marrja e rezultateve nga Qeveria për konceptimin e Dokumentit të Programuar të PDPL-së (që t'i dërgohet qeverisë përpara se të fillojë misioni); arritja e një marrëveshjeje për politikën që do të mbështetën nga PDPL1, si dhe politikën që do të mbështetën nga PDPL2 dhe PDPL3; rakordimi për rezultatet e pritshme për reformat e propozuara, me të dhëna bazë të mundësuar nga Ministritë përkatëse; diskutimi për kronologjinë e vënis në zbatim të reformave të propozuara nga PDPL; prezantimi i programit PDPL te donatorët kyç për të siguruar bashkëpunimin; dhe rakordimi për hapat e ardhshme.

Projekti i Shpërndarjes së Shërbimeve Sociale, Mision Mbikëqyrës, mbajtur nga 7 deri më 13 Qershor 2011

Objektivat kyç të misionit ishin: rishikimi i statusit të zbatimit të projektit, me fokus të veçantë në arkivat dhe aktivitetet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH); diskutimet e detajuara me menaxherë të ISSH për zyrat rajonale të propozuara të ISSH-së dhe për rehabilitimin fizik të tyre, të mbështetur nga fondet e projektit; vizitat në arkivat e ISSH-së dhe në disa zyra, si objekt i mbështetjes së projektit; dhe rishikimi i shifrave të rimbursimit të projektit (aktuale dhe të projektuar).

Fondi i Besimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (P105143), Mision Mbikëqyrës, mbajtur nga 6 deri 18 Qershor 2011

Projekti do të ketë si objektiva kyçe: rishikimin e rezultateve të arritura nën FB-SHD-në për Krijimin dhe Mbështetjen e Kapaciteteve për zbatimin e SPI-së (P105143) dhe diskutimin e aktiviteteve të reja në të ardhmen nën një projekt me homologët në Qeveri dhe donatorët e FB-SHD-së.

Projekti për Fuqizimin e Zbatimit të Konventës Aarhaus, Mision Mbështetës dhe Zbatues, mbajtur nga 27 deri 28 Qershor 2011.

Objektivat kyç të misionit ishin: vlerësimi i progresit në zbatimin e projektit që nga misioni i fundit i mbështetjes në

Misionet në vend

Nëntor 2010, i përqendruar në statusin e veprimeve mbi të cilat është rënë dakord; kontrolli dhe arritja e një marrëveshjeje për ndonjë rishikim të aktiviteteve të planifikuara të projektit; vënia në zbatim e marrëveshjeve dhe/ose planit të prokurimit për të siguruar arritjen efikase të objektivave të projektit, bazuar në progresin e bërë; rishikimi i kontrollit dhe vlerësimi të marrëveshjeve dhe progresi i arritur në treguesit kyç të projektit; dhe përditësimi i planit të veprimit për zbatimin e projektit për 12 muajt e ardhshëm.

Granti i Fondit Japonez i Zhvillimit Social për Fuqizimin e Rolit të Rinisë nëpërmjet Pjesëmarrjes në Komunitet, Mision mbështetës dhe zbatues, mbajtur nga 21 deri 25 Qershor 2011.

Progresi i zbatimit të projektit ka qenë inkurajues dhe me kërkesa të larta në forcimin e kapaciteteve. Është nevojë për një bashkëpunim më të mirë mes grupit të zbatimit të projektit dhe bashkisë së Durrësit, për të përmirësuar forcimin e kapaciteteve në atë bashki. Misioni do të mon-

itorojë punën e bashkisë së Durrësit dhe mund t'ia kalojë fondet e projektit bashkisë së Tiranës, nëse s'shikohet asnjë përmirësim.

Një Mision për Projektin e Modernizimit të Ndihmës Sociale, mbajtur nga 5 deri 18 Qershor 2011

Qëllimi i vizitës ishte të kryeshin disa teste paraprake në terren për formulën e re të llogaritjes dhe përgatitjes së pyetësorit për Programin e Ndihmës Ekonomike. Gjatë këtyre testeve paraprake, grupi i Bankës Botërore do të punojë bashkë me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që: të testohet dhe të vëzhgohet procesi i intervistimit duke përdorur formularë dhe një formulë përllogaritjeje; të vlerësohet dhe përpunohet formula dhe pyetësori bazuar në vëzhgimet e testeve paraprake; të forcohet kuptimi dhe zotërimi i formulës dhe pyetësorit në grupet e Ministrisë dhe administratës lokale, që të mundësojnë një platformë për të përcaktuar reformat pilot për Programin e Ndihmës Ekonomike.

dialoguqeveridonatorë

Që nga 15 Dhjetori 2010 deri në fund të Qershorit 2011, Banka Botërore ka Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve.

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë me se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.como@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (koordinimi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t'ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

Për t'u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.como@aidharmonisation.org.al)

OSCE Government-Donor Dialogue Newsletter
is supported by the OSCE Presence in Albania

